

E DREJTA PËR INFORMIM

Rregullimi i lobimit në Shqipëri

Rregullimi i veprimtarisë së lobimit në Shqipëri, sfidat e zbatimit dhe koordinimi me standardet evropiane ishin në fokus të tryezës së organizuar në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Evropian, me pjesëmarrjen e institucioneve publike, shoqërisë civile, ekspertëve dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Aktiviteti u organizua, nga Lëvizja Evropiane në Shqipëri (EMA) në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të Grupit të Punës për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”.



Në fjalën e tij, Komisioneri Besnik Dervishi e cilësoi ligjin nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” si një hap të rëndësishëm drejt forcimit të integritetit institucional, transparencës dhe llogaridhënies në proceset vendimmarrëse publike. Sipas Komisionerit, për herë të parë në Shqipëri krijohet një kuadër i posaçëm ligjor që synon të garantojë se ndërveprimi mes interesave private dhe institucioneve publike zhvillohet në mënyrë të deklaruar, të monitorueshme dhe në përputhje me interesin publik.

“Ky ligj merr një rëndësi të veçantë pikërisht sepse prek dhe rregullon ndërveprimin me nivelet më të larta të vendimmarrjes në shtet. Të lundrosh në kufijtë e ligjit apo të kërkosh koordinata ligjore në proceset vendimmarrëse, nga deputetët te Kryetari i Kuvendit, nga ministrat te Kryeministri, nga drejtuesit e administratës te kryetarët e bashkive, kërkon jo vetëm transparencë formale, por standarde të forta integriteti institucional”, u shpreh Komisioneri Dervishi.

Në tryezë u prezantuan gjithashtu, aspektet që lidhen me funksionimin dhe menaxhimin e Regjistrimit të Lobimit, funksionet mbikëqyrëse dhe kontrolluese të Komisionerit, si dhe nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të ligjit, etj.

Vendimmarrja e Komisionerit

*Vendim nr. 16 - Autoriteti
Kombëtar i Ushqimit*

*Vendim nr. 17 - Komisioni i
Prokurimit Publik*

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë muajit maj 2026 ka dhënë dy vendime në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Sipas [vendimit nr. 16, datë 14.05.2026](#), Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (në vijim “Autoriteti Publik”) me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës së datës 24.11.2025, depozituar pranë degës rajonale të autoritetit publik, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me: *Listën e plotë të nipteve për subjektet që ju keni bllokuar misrin në doganë nga 1 shtatori 2025 deri ne 22 nëntor 2025.*

Autoriteti publik, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion, duke sqaruar se: “Autoriteti Publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr. 99/2024, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Referuar këtij ligji, veprimtaria inspektuese bazohet, ndër të tjera, në parimin e konfidencialitetit, të parashikuar shprehimisht në nenin përkatës të ligjit të inspektimit dhe, konkretisht Neni 10 “Parimi i informimit të publikut dhe mbrojtjes së konfidencialitetit”, sipas të cilit informacionet dhe të dhënat e siguruara gjatë procesit të inspektimit nuk mund të bëhen publike apo t’u vihen në dispozicion palëve të treta.”

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, kërkuari me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të LDI.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi.

Në vijim, Autoriteti Publik ka konfirmuar se “Referuar nenit 10 të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë (...) informacioni i përftuar gjatë inspektimeve, nuk mund të bëhet publik apo t’u vihet në

dispozicion palëve të treta, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga ligji. Lista e plotë e subjekteve tregtare dhe numri unik i identifikimit të tyre (NUIS), ndaj të cilëve janë marrë masa administrative, përbën informacion që lidhet me veprimtarinë tregtare dhe statusin ligjor të subjekteve, si dhe përmban të dhëna që gëzojnë mbrojtje ligjore në aspektin e konfidencialitetit tregtar dhe mbrojtjes së të dhënave personale (...).

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerësoi se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI. Pretendimet e mësipërme, nuk qëndrojnë, pasi informacioni i kërkuar lidhet me sigurinë ushqimore dhe si rrjedhojë paraqet interes të lartë publik. Konstatohet se, Autoriteti Publik në argumentin e parashtruar për mos dhënie të informacionit, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, propocionale, si dhe dëmin që mund t’u shkaktojë bizneseve/kompanive si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar. Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 18 të ligjit nr 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, parashikohet se: “2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik”.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës, duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Bashkëpunim rajonal dhe inovacion në të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi një takim tre-ditor pune, përkatësisht në datat 28-30 prill 2026, me pjesëmarrjen e delegacioneve të Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës dhe Agjencisë Kroate për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Aktiviteti u zhvillua në prani të Komisionerit z. Besnik Dervishi dhe Komisioneres së Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës, znj. Krenare Sogojeva Dermaku, të cilët vlerësuan bashkëpunimin ndërinstytucional si një element kyç për përbashkëtimin e sfidave të përbashkëta dhe garantuan thellimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Në përputhje me agjendën, dita e parë e takimit nisi me vizitën zyrtare të delegacionit të Agjencisë Kroate për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AZOP) në ambientet e Zyrës së Komisionerit. Gjatë këtij takimi u zhvilluan diskutime mbi qasjet institucionale, prioritetet dhe përvojat përkatëse në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke krijuar bazën për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve dhe përgatitjen e një angazhimi të përbashkët në kuadër të thirrjes së Komisionit Evropian “CERV-2026-DATA”.



Dita e dytë vijoi me takimin trepalësh me pjesëmarrjen edhe të Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës, ku diskutimet u përqendruan në konkretizimin e bashkëpunimit dhe avancimin e përgatitjes së një projekti të përbashkët. Në këtë kuadër, pala kroate e përfaqësuar nga znj. Anamarija Mladinic prezantoi platformën “Olivia”, një mjet inovativ për mbështetjen e funksioneve të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave dhe ndërveprimin me publikun. U vlerësua si një praktikë e avancuar, me potencial për t’u adaptuar edhe nga Shqipëria dhe Kosova, në funksion të modernizimit të proceseve dhe rritjes së efikasitetit institucional.

Ndërsa dita e tretë e këtij takimi u fokusua në shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet dy autoriteteve të Shqipërisë dhe Kosovës. Nga Zyra e Komisionerit u prezantuan disa prej instrumenteve dhe praktikave kryesore në të dyja fushat e përgjegjësisë.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:



Digjitalizimi dhe forcimi i proceseve institucionale të punës në qendër të workshop-it të organizuar nga PACEPII


Përfaqësues të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, morën pjesë në një workshop të organizuar nga proekti PACEPII, i fokusuar në shkëmbimin e praktikave më të mira për përmirësimin e proceseve institucionale të punës. Gjatë workshop-it u diskutua mbi qasje të reja për raportime periodike dhe vjetore më efektive, integrimin e indikatorëve të performancës në sistemet e raportimit, ristrukturimin e raporteve në përputhje me kërkesat e Kuvendit për institucionet e pavarura.



Diskutimet evidentuan gjithashtu rëndësinë e digjitalizimit të sistemeve të trajtimit të ankesave, si dhe të proceseve të brendshme të punës me synim rritjen e efikasitetit dhe modernizimin e proceseve të punës në institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut.

Shkëmbimi i eksperiencave dhe bashkëpunimi ndërinstytucional u vlerësuan si elementë të rëndësishëm për forcimin e institucioneve të pavarura dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Takimi i 5-të i Komitetit të Planifikimit të ICIC



Pas miratimit në parim të agjendës së sesionit të hapur nga anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të ICIC dhe të Komitetit të Planifikimit, u zhvillua takimi i 5-të online i Komitetit të Planifikimit ku u diskutua mbi hapat e ardhshëm organizativ të Konferencës së ICIC, që do të bashkë-organizohet me UNESCO-n në Sierra Leone në datat 28-30 shtator 2026.

Zyra e Komisionerit në cilësinë e Sekretariatit moderoi takimin, gjatë të cilit u ngritën disa çështje teknike si zhvendosja e takimeve të rrjeteve rajonale, konkretisht rrjeti latin dhe ai evropian, ku marrin pjesë njëkohësisht kolegë nga homologët e Spanjës dhe Portugalisë. Gjithashtu, u diskutua mbi fillimin e punës për hartimin e një deklaratë të përbashkët ICIC – UNESCO ku anëtarët propozuan z. Mendel nga CLD për hartimin e draftit të parë. Në cilësinë e organizatorit, Komisioneri Shaw i Sierra Leone ftoi të gjithë pjesëmarrësit për shprehjen e interesit për të marrë pjesë në panelet e konferencës si folës.